



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

RAPORT

**Për veprimtarinë e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe
Parashtresa (PZAP)**

01 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2013

Prishtinë, Janar 2014

Rr. "Luan Haradinaj" Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati i -I-. 10 000 Prishtinë
info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org, 038 211-242



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

RAPORT

**Për veprimtarinë e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe
Parashtresa (PZAP)**

01 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2013

Prishtinë, Janar 2014

Rr. "Luan Haradinaj" Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati i -I-. 10 000 Prishtinë
info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org, 038 211-242

P Ë R M B A J T J A

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)	1
Hyrja	1
Misioni.....	1
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT	2
Përbërja e PZAP-it - Kryetari dhe Anëtarët panelit të PZAP-it	2
Përbërja e panelit të PZAP-it.....	2
FUNKSIONET, PËRGJEGJËSITË DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË PZAP-it	3
Organogrami i PZAP-it.....	4
Aktivitetet e PZAP-it dhe të Sekretariatit	5
AKT EMËRIMET E SHËRBYESVE CIVIL DHE VLERËSIMET E PUNËS PËR PERSONELIN E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT	6
Miratimi i rregullores Për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP.....	6
Rekrutimi i Stafit jo permanent gjatë procesit zgjedhor 2013	6
Zyra Ligjore.....	6
PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE QASJA NË INFORMATAT ZYRTARE	7
KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-it	8
Komisionet e përkohshme të PZAP-it	8
PUNËTORITË E PZAP-IT TË MBAJTURA NË VITIN 2013	9
Pjesëmarrja e anëtareve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit të PZAP-it në vizita dhe grupe punuese në vend dhe jashtë vendit	9
Vizita në Maqedoni	9
Vizita në Shqipëri	9
Vizita në Bruksel.....	9
SHPENZIMEVE VJETORE PËR VITIN FISKAL-2013	10
Ndarjet Buxhetor	10
BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR VITIN – 2013	10
Buxheti i aprovuar i PZAP-2013	10
BUXHETI I SHPENZUAR PËR VITIN 2013	12
PJESA PËRMBYLLSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE	14
TE HYRAT E PZAP-it	15
BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	20
Bashkëpunimi i PZAP-it me Komisionin Qendror Zgjedhor – KQZ.....	20
Bashkëpunim i PZAP-it, me Policinë e Kosovës	20
Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatën Supreme të Kosovës.....	21
Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatat Themelore në Kosovë	21
Bashkëpunimi i PZAP-it, me Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM)	21

Bashkëpunimi i PZAP-it, me Prokurorinë e Shtetit	21
Bashkëpunim i PZAP-it, me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE	22
Bashkëpunim i PZAP-it, me IFES-in	23
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE STATISTIKA PËR ZGJEDHJET LOKALE TË VITIT 2013	23
NATYRA E ANKESAVE TË PARAQITURA NË PZAP GJATË PROCESIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË VITIT 2013	27
RASTET E DËRGUARA NË PROKURORINË E SHETITIT	40
PADITË E PARAQITURA NDAJ VENDIMEVE TË PZAP-IT NË GJYKATËN SUPREME	40
ANKESAT E PRANUARA NË PZAP NGA VOTUESIT JASHTË KOSOVËS.....	42
MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT	44
REKOMANDIMET E PZAP-IT LIDHUR ME SFIDAT GJATË BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET TJERA GJATË VITIT 2013	47

1 PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)

1.1 Hyrja

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), si institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij i cili është kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet që parashtrihen në PZAP nga palët e interesuara e që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me ligjin dhe rregullat zgjedhore.

PZAP-i, në zbatim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP-së dhe Rregullave Zgjedhore, siguron të gjitha palët e involvuara në procesin zgjedhor të jenë të barabarta pavarësisht përkatësisë etnike apo fetare.

PZAP-i, zhvillonë politika dhe strategji që t'i siguron të gjitha palët e involvuara në procesin zgjedhor të jenë të barabarta pavarësisht përkatësisë etnike apo fetare.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të tij e ushtron funksionin sipas nenit 115 të Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr. 03 / L-072), i cili gjatë vitit 2013, ka arritur që me sukses të vendos për të gjitha ankesat dhe apelet e parashtruara gjatë procesit zgjedhor.

1.2 Misioni

Misioni i PZAP-it, është mbrojtja e të drejtave zgjedhore, respektivisht Zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare, si për nivelin qendror ashtu edhe për nivelin lokal.

2. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT

Siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kryesuesi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me vendimin Agj.nr. 685/2010 të datës 08.11.2010, ka emëruar Kryesuesin e PZAP-it, nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe anëtarët e PZAP-it nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatave të Qarkut.

2.1 Përbërja e PZAP-it - Kryesuesi dhe Anëtarët panelit të PZAP-it

1. Shukri Sylejmani, Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesues i PZAP-it
2. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës së Qarkut – Prizren, anëtarë,
3. Muharrem Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Pejë, anëtarë,
4. Hasan Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Pejë, anëtarë,
5. Xhevdet Abazi, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Mitrovicë, anëtarë,
6. Ferit Osmani, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Mitrovicë, anëtarë,
7. Nehat Idrizi, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Prishtinë, anëtarë,
8. Rafet Haxhaj, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Prishtinë, anëtarë,
9. Muhamet Rexha, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Gjilan, anëtarë dhe
10. Vlastimir Dimic, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Gjilan, anëtarë.

Pas dorëheqjes së Vlastimir Dimić, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Gjilan dhe anëtarë i PZAP-it me vendimin Agj.nr. 539/2012 të datës 09.11.2012 është emëruar anëtar i PZAP-it Nenad Laziq, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

2.2 Përbërja e panelit të PZAP-it

PZAP-i, përbëhet nga 10 (dhjetë) anëtarëve përfshirë këtu edhe kryesuesin dhe mund të mbledhet në panele prej së paku 3 (tre) anëtarëve, prej të cilëve një është kryesues.

Anëtarët e emëruar të PZAP-it sipas LZP-së, gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtarë të PZAP-it.

Për çdo panel caktohet një kryesues i panelit për seancën e caktuar. Kryesuesi i Panelit të PZAP-it cakton përbërjen e paneleve.

3. FUNKSIONET, PËRGJEGJËSITË DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË PZAP-it

Duke u bazuar në nenin 123 të LZP-së PZAP-i, në ushtrimin e përgjegjësisë dhe funksioneve të tij ndihmohet nga Sekretariati.

Sekretariati i PZAP-it:

- pranon ankesa dhe apele gjatë procesit zgjedhor;
- arkivon të gjitha shkresat që parashtrihen në PZAP;
- Drafton/harton vendime të ndryshme të SPZAP-it;
- Me autorizim të panelit heton/mbledh fakte për vendosjen e ankesave të parashtruara në PZAP;
- Harton raporte për rezultatin e hetimeve;
- Me rekomandim të panelit përgatit rastet që supozohen se kanë elemente të veprës penale dhe i dorëzon në Prokurorinë Shtetërore të Republikës së Kosovës;
- Përgjigjet në të gjitha kërkesat e institucioneve të cilat janë duke i hetuar rastet me elemente të veprës penale;
- Menaxhon dhe ekzekuton buxhetin vjetor;
- Përkthen vendimet në të gjitha gjuhët sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës;
- Mirëmban adresë zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë.

Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it, nën drejtimin e Kryesuesit të PZAP-it, është përgjegjës për:


- Të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it;
- Përgatitjen e paneleve të PZAP-it, duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- Organizimin e Sekretariatit dhe zhvillimin e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionimin e PZAP-it.
- Menaxhon buxhetin vjetor të ndarë nga Buxheti i Republikës së Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e PZAP-it, duke u bazuar në propozim buxhetin e dorëzuar nga Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it.

Me buxhetin e propozuar për vitin 2013 dhe i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës PZAP-i, nuk ka pasur ndryshime nga viti paraprak sa i përket numrit të aprovuar të stafit, respektivisht i ka të lejuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtarë të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të administratës.

Marrëdhënia e punës së personelit të sekretariatit të PZAP-it, rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13 maj 2010.

Sekretariati i PZAP-it, ka këtë strukturë të brendshme të organizimit: Kryesuesin e Sekretariatit i cili është ekuivalent me pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë, Udhëheqësin e Zyres Ligjore të Sekretariatit, ekuivalent me pozitën e Drejtorit të Departamentit, Zyrtarin Kryesor Financiar, ekuivalent me pozitën e Drejtorit të Departamentit, tre Zyrtarë të Lartë Ligjorë, Koordinatorin e Përkthimeve Shqip-Serbisht dhe anasjelltas, Zyrtarin për Teknologji Informative dhe Logjistikë, Asistentin Ekzekutiv/Arkiv dhe Zyrtarin e Transportit.

Organogrami i PZAP-it



3.1 Aktivitetet e PZAP-it dhe të Sekretariatit

PZAP-i, në zbatim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim të përmbushjes së funksioneve dhe përgjegjësisë të tij të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës, në fillim të vitit ka përgatitur dhe miratuar një plan të punës në të cilin plan janë paraqitur dhe përfshirë objektivat e Institucionit të PZAP-it për vitin 2013. Në këtë plan vjetor për shkak të natyrës së mandatit të Institucionit të PZAP-it, detyrave dhe punëve që mund të këtë gjatë një viti, përveç paraqitjes së objektivave të rregullta ka paraparë edhe objektiva alternative, siç janë: Zgjedhjet e Jashtëzakonshme të mundshme për nivelin qendror apo lokal.

PZAP-i, të gjitha objektivat e parapara në planin e punës i ka përmbushur si në aspektin kualitativ ashtu edhe në atë kuantitativ. Kryerja me sukses e procesit të Zgjedhjeve të Rregullta Lokale, të cilat janë mbajtur me 3 nëntor 2013 ka qenë një prej aktiviteteve kryesore të parapara dhe të realizuara në objektivat e Planit të vitit 2013.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), gjatë tërë proceseve zgjedhore ka dëshmuar se është organ apolitik, i pavarur, i vendosur dhe i aftë në zgjidhjen e rasteve të ndryshme për Zgjedhjet Lokale të vitit 2013.

PZAP-i, të gjitha ankesat dhe apelet e lejuara të parashtruara nga palët e interesuar për proceset zgjedhore të sipërshënuara i ka vendosur duke u bazuar në LZP, Rregullat Zgjedhore, Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, në afatet e parapara ligjore me çka Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), i ka mundësuar shpalljen e rezultateve përfundimtare dhe certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve.

Efikasiteti dhe efektiviteti i Institucionit të PZAP-it, i treguar në këtë proces zgjedhor të cekur më lartë si dhe në proceset zgjedhore të më hershme ka treguar dhe po tregon performancën e mirë të këtij Institucioni e cila performancë është bërë e njohur për publikun dhe Institucionet e vendit. Ngritja e performancës në kuptimin kualitativ e ka rritur besimin e publikut.

4. AKT EMËRIMET E SHËRBYESVE CIVIL DHE VLERËSIMET E PUNËS PËR PERSONELIN E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT

Me qenë se, PZAP-i, për vitin 2013 nuk ka pasur vende të lira për rekrutimin e stafit për arsye se të gjitha vendet e lejuara me buxhet i ka të plotësuar, në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13 maj 2010 dhe akteve nënligjore të nxjerrura në pajtim me këtë ligj, i ka lëshuar akt emërimet e karrierës pa afat për të gjithë shërbyesit civil nga niveli me i ulët deri te niveli me i lartë si dhe është bërë vlerësimi i punës dhe përforma e zyrtarëve të sekretariatit të PZAP-it për vitin 2013.

4.1 Miratimi i rregullore Për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP

Në pajtim me Rregulloren Nr. 09/2012 Për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, PZAP-i, ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të punës për institucionin tij dhe në afatin e paraparë ligjorë e ka dorëzuar në Ministrinë e Administratës Publike për procedurë të mëtejme.

4.2 Rekrutimi i Stafit jo permanent gjatë procesit zgjedhor 2013

PZAP-i me qëllim të perballimit me sukses të procesit Zgjedhor të Zgjedhjeve të Rregullta Lokale, të mbajtura me 3 nëntor 2013, sipas planifikimit të bërë për vitin 2013 dhe sipas kërkesave dhe nevojave të Institucionit përmes konkursit publik ka rekrutuar dhe angazhuar 10 (dhjetë) zyrtar jo permanent prej tyre 6 (gjashtë) Zyrtar Ligjor dhe 4 (katër) asistentë ekzekutiv. Kohëzgjatja e rekrutimit dhe angazhimit të këtyre zyrtarëve varesisht prej kërkesave nëvojës dhe arsyes që ka pasur instucioni ka qene prej 2 (dy) deri ne 4 (kater) muaj. Rekrutimi dhe angazhimi i këtyre zyrtarëve është bere me qëllim të perballimit dhe tejkalimit me sukses procesit zgjedhor per vitin 2013 e ne veçanti te fazës se procesit zgjedhor per Votuesit Jashtë Kosovës i cili proces për PZAP-in, ka qenë mjaftë sfidues, por qe me angazhimin dhe përkushtimin e gjithë stafit të sekretariatit të PZAP-it atij permanent dhe jo permanent si dhe të anëtarëve të PZAP-it me sukses është perballuar dhe është tejkeluar Votimi i Votuesve Jashte Kosoves, ku gjate ketij procesi ne PZAP, jane pranuar, shqyrtuar dhe vendosur 16 410 ankesa dhe lidhur me keto ankesa me vendime jane njoftuar te gjitha palet ankuese.

4.3 Zyra Ligjore

Aktivitetet e Zyrtarëve të Zyrës Ligjore kanë qenë si në vijim:

- Aktiviteti lidhur me Mësimet e nxjerra nga zgjedhjet e kaluara, mangësitë dhe përparësitë e LZP-së dhe rregullave tjera zgjedhore;
- Rekomandimet për ndryshimin e disa neneve të LZP-së;

- Rekomandimet lidhur me statusin e PZAP-it për Grupin Punues Zgjedhor (GPZ);
- Veprime administrative lidhur me hetimin e rasteve të ndryshme për zgjedhjet;
- Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës sa i përket hetimeve për parregullsitë gjatë procesit të zgjedhjeve lokale te vitit 2013,
- Bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit lidhur me dorëzimin e rasteve që kanë elemente të veprës penale në bazë të KPK-së, për zgjedhjet lokale te vitit 2013;
- Përgatitja e shkresave të ndryshme për Gjykata të ndryshme nëpër Kosovë për rastet që janë në procedurë.

Kthimi i përgjigjeve në kërkesat e parashtruara nga gjykatat e ndryshme komunale nëpër Kosovë për rastet që janë në procedurë lidhur me zgjedhjet e kaluara.

Bashkëpunimi në vazhdimësi PZAP-it me Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror Zgjedhor – KQZ-së, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërlidhura të përcaktuara me LZP, siç janë periudha e sfidimit, konfirmimi i certifikimit të subjekteve politike për pjesëmarrje në zgjedhje, ankesat që ZRPPC-ja i adreson PZAP-it për mos deklarimin e raportit financiar nga ana e subjekteve politike etj.

5. PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE QASJA NË INFORMATAT ZYRTARE

PZAP-i, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve të gjitha vendimet dhe dokumentet tjera zyrtare i ka përkthyer në gjuhët zyrtare.

Gjatë vitit 2013, zyra për koordinimin e përkthimeve ka përkthyer nga gjuha shqipe në atë serbe këto dokumente:

Vendimet e ndryshme të PZAP-it për Zgjedhjet Lokale te vitit 2013 me të cilat vendime janë njoftuar palet e intersuara në gjuhën e tyre amtare, Raportin Vjetor të PZAP-it për vitin 2013, Raportin Financiar me të gjitha pjesët të tij për vitin 2013, Raportet tremujore të Buxhetit të PZAP-it për vitin 2013, Kërkesat Buxhetore, Njoftimet për Ëeb faqe zyrtare të PZAP-it.

PZAP-i, ka adresën zyrtare dhe mirëmban faqen zyrtare të tij ku të gjithë të interesuarit kanë mundësi të kenë qasje në informatat e Institucionit si për mënyrën e organizimit të institucionit, Legjislacionin e PZAP-it, vendimet e publikuara në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, raportet vjetore, komunikata si dhe shkresat tjera.

6. KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-it

Në bazë të ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, PZAP-i, me qëllim të ushtrimit të funksionit dhe përgjegjësive të tij ka të formuara disa komisione të Përherëshëm siç janë:

- 1 Komisioni për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pesë) anëtarëve të panelit,
- 2 Komisioni për Buxhet dhe Personel i përberë prej 5 (pesë) anëtarëve të panelit,
- 3 Komisioni Disiplinor i përberë prej Zyrtareve të Lartë të Sekretariatit,
- 4 Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përberë prej Zyrtarve të Lartë të Sekretariatit.

Komisioni për Çështje Ligjore është komision i përherëshëm i cili përbehet nga anëtarët e PZAP-it të cilët në mënyrë të përherëshme merren me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me fushën e kompetencave dhe të mandatit të Institucionit të PZAP-it, të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe amendamentimin e Rregullave dhe Procedurave të brendshme të PZAP-it.

Ky komision në punëtoritë dhe takimet e mbajtura ka dhënë kontributin dhe ekspertizën profesionale lidhur me reformën zgjedhore sa i përket mandatit të PZAP-it të përcaktuar me ligj.

Komisioni për Buxhet është komision i përherëshëm i cili përbehet nga anëtarët e PZAP-it i cili në mënyrë permanente procedon çështjet e buxhetit dhe të personelit të PZAP-it. Ky komision në punëtoritë dhe takimet e mbajtura ka dhënë kontributin dhe ekspertizën profesionale në çështjet e buxhetit dhe personelit të sekretariatit si janë struktura organizative e sekretariatit, nxjerrjen dhe miratimin e Rregullores për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP etj.

Ndërsa komisionet nën nr. rendor 3 dhe 4 janë komisione të përherëshme të cilat merren me çështjet e procedurave disiplinore dhe të ankesave të personelit të administratës së Sekretariatit, respektivisht me çështjet e marrëdhënies së punës të shërbyesve civil të sekretariatit.

6.1 Komisionet e përkohshme të PZAP-it

Komisioni për Inventarizimin e Pasurisë, Komisioni për Vlerësimin e Pasurisë dhe Komisionet tjera të përkohshme, kanë për qëllim menaxhimin dhe vlerësimin e pasurisë së PZAP-it, në pajtim me aktet nënligjore të Qeverisë.

7 PUNËTORITË E PZAP-IT TË MBAJTURA NË VITIN 2013

Punëtorja e mbajtur në Durrës nga data 13 – 17 mars 2013, të cilin e ka organizuar PZAP-i.

Në këtë takim janë diskutuar çështjet të ndryshme siç janë:

- Rekomandimet e PZAP-it, të adresuar në Grupin Punues për Reformën Zgjedhore;
- Koordinimi i PZAP-it, me Institucionet tjera siç janë: Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, KQZ-ja etj, lidhur me procesin zgjedhor;
- Korniza Ligjore, mangësitë apo të metat e kësaj kornize që janë vërejtur gjatë proceseve zgjedhore;
- Prezantimi i raportit vjetorë të PZAP-it.

7.1 Pjesëmarrja e anëtareve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit të PZAP-it në vizita dhe grupe punuese në vend dhe jashtë vendit

Anëtarët dhe Personeli i Sekretariatit të PZAP-it me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të Institucionit dhe performancës së tij kanë marrë pjesë brenda dhe jashtë vendit në vizita studimore, trajnime dhe seminare të ndryshme.

7.2 Vizita në Maqedoni

Një delegacion i PZAP-it në përbërje nga Kryesuesi i PZAP-it, dy anëtarë të panelit, kryesuesi i Sekretariatit dhe Udhëheqësi i Zyrës Ligjore kanë marrë pjesë në vëzhgimin e procesit zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Maqedonisë të mbajtura me 23 mars 2013, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ngritjen e kapaciteteve si në aspektin organizativ të zgjedhjeve poashtu edhe në atë ankimor, respektivisht në përfitimin e përvojave në aspektin e mbrojtjes së të drejtës zgjedhore.

7.3 Vizita në Shqipëri

Një delegacion i PZAP-it në përbërje nga Kryesuesi i PZAP-it, katër anëtarë të panelit, kryesuesi i Sekretariatit dhe një Zyrtarë i Lartë Ligjor, kanë marrë pjesë në vëzhgimin e procesit zgjedhor të Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Shqipërisë të mbajtura me 23 qershor 2013, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ngritjen e kapaciteteve si në aspektin organizativ të zgjedhjeve poashtu edhe në atë ankimor, respektivisht në përfitimin e përvojave në aspektin e mbrojtjes së të drejtës zgjedhore.

7.4 Vizita në Bruksel

Kryesuesi i PZAP-it, si pjesë teknike e delegacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka marrë pjesë në tri takime punuese të mbajtura në Bruksel, lidhur me procesin zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale të cilat janë mbajtur me 3 nëntor 2013. Në këto takime është biseduar për procesin ankimor të Votuesve Jashtë Kosovës.

Stafi i sekretariatit përfshirë në përbërje prej tre zyrtarëve, kanë marrë pjesë në disa trajnime brenda dhe jashtë vendit në të cilat trajnime janë trajtuar temat si ne vijim: Procesi i Planifikimit, Ekzekutimit dhe Auditimit të Buxhetit, Komunikimi Efektiv në Institucione, Zbatimi i Ligjit dhe Arsytimi i Vendimeve, Prokurimit Publik, Niveli Themelor.

8. SHPENZIMEVE VJETORE PËR VITIN FISKAL-2013

8.1 Ndarjet Buxhetore

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0170. PZAP-i, financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2013 përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP, dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimit të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€)

Shumat raportuese janë në njësi në €

9. BUXHETI I PLANIFIKUAR PER VITIN - 2013

Për vitin 2013 për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndare buxhet në shumë prej 268,986.00€.


9.1 Buxheti i aprovuar i PZAP-2013

Përshkrimi	Buxheti i aprovuar 2013	Total Buxheti
Paga dhe mëditje	160,184.00	160,184.00
Mallra dhe shërbime	99,602.00	99,602.00
Shërbime Komunale	9,200.00	9,200.00
Total	268,986.00	268,986.00

9.2 Struktura e buxhetit për vitin 2013

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it në shume prej 268,986.00 € si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre:

- 59.55 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 37 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 3.4% për shpenzimet komunale.



10. BUXHETI I SHPENZUAR PER VITIN 2013

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2013, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it për vitin 2013 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket në vijim:

10.1 Paraqitja e buxhetit të shpenzuar për vitin fiskal 2013 në formë tabelare

Kategorit Ekonomike	Total buxheti i Aprovuar	Buxheti i shpenzuar	Përqindja (%)
Paga dhe mëditje	160,184.00	132,687.55	82.83%
Mallra dhe shërbime	99,602.00	70,199.57	70.48%
Shërbime Komunale	9,200.00	7,967.99	86.60%
Total:	268,986.00	210,855.11	78.40%

10.2 Paga dhe mëditjet

Për vitin 2013 për Kategorinë se Pagave dhe Mëditjeve janë planifikuar mjete në vlerë prej 160,184.00€. Janë realizuar 132,687.55€ apo buxheti është shpenzuar 82.83%.

Dallimi në mes të Planifikimit dhe realizimit të Buxhetit është se të gjithë anëtarët e Panelit pagën në PZAP e marrin si pagë sekondare ndërsa në jemi të obliguar të planifikojmë Buxhetin në bazë të Vendimit të Qeverisë, andaj këtu na del një ndryshim në mes Buxhetit të Planifikuar dhe të Realizuar sa i përket kategorisë se Pagave dhe Mëditjeve.

Mirëpo në krahasim me shpenzimet e vitit të kaluar këtë vit Buxheti për paga është realizuar më shumë për arsye se për shkak të angazhimeve me të shtuara të anëtareve të PZAP-it dhe personelit të Sekretariatit të PZAP gjatë procesit Zgjedhor të këtij viti, në bazë të një vendimi të Qeverisë të njëjtit kanë marrë pagë shtesë 60% të pagës bazë për muajin shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2013.

10.3 Mallra dhe shërbime

Për vitin 2013, janë planifikuar mjete në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 99,602.00€. Këto mjete u shpenzuan në shumë prej 70,199.57€ apo buxheti është shpenzuar 70.48%. Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:

- Modullit të aprovimeve dhe
- Modullit të blerjeve-prokurimit.

Me poshtë janë te prezantuar shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2013.

10.4 Paraqitja e Mallrave dhe shërbimeve në mënyrë të detajuar

në €

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2013
Mallra dhe Shërbime	70,199.57
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	17,998.66
Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit	2,771.70
Shërbimet tjera telefonike vala 900	7,180.00
Shërbimet kontraktuese tjera	9,292.14
Shërbimet postare	103.95
Harduer për teknologji informative < 1000	
Furnizimi për Zyre	17,815.00
Shërbime teknike	
Karburant për vetura	4,221.99
Sigurimi i automjeteve	799.59
Regjistrimi i automjeteve	235.00
Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve	757.38
Mirëmbajtja e ndërtesave	2,970.00
Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	2,430.20
Shpenzimet për informim publik	932.90
Pajisje trafiku	
Drekat zyrtare	2,691.06

10.5 Shpenzimet komunale


Buxheti i aprovuar i shpenzimeve komunale për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është në shumë prej 9,200.00€. Krahasuar me buxhetin e planifikuar shpenzimet u realizuan 86.60%, çka do të thotë se buxheti është shpenzuar 7,967.99€.

11 PJESA PËRMBYLLSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe databazës të Sekretariatit të PZAP-it mund të përfundojmë se për vitin 2013 Buxheti u shpenzua **210,855.11€**. Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2013.

11.1 Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe të shpenzuara të PZAP-it për vitin 2013

Krahasimi në mes të Planifikimit dhe Realizimit të Buxhetit



14 TE HYRAT E PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP-i)) në bazë të nenit 120 paragrafi 1. pika c. të Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet Lokale të mbajtura në vitin 2013, ka shqiptuar gjoba ndaj subjekteve politike në shumë prej 190,550.00 euro.

14.1 Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të gjitha gjobat e shqiptuara dhe të realizuara për Zgjedhjet Lokale - 2013

Nr.	Nr. I vendimit te PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Data e marrjes se Vendimit	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	Anr. 139/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	05.10.13	800	800	0.00
2	Anr. 165/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	09.10.13	5,100	5,100	0.00
3	Anr. 195/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	09.10.13	5,150	5,150	0.00
4	Anr. 248/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	850	850	0.00
5	Anr. 259/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	900	900	0.00
6	Anr. 260/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	950	950	0.00
7	Anr. 272/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	1,000	1,000	0.00
8	Anr. 275/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	1,000	1,000	0.00
9	Anr. 277/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	1,050	1,050	0.00
10	Anr. 287/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	1,100	1,100	0.00
11	Anr. 289/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	1,150	1,150	0.00
12	Anr. 291/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	1,200	1,200	0.00
13	Anr. 305/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25.10.13	1,250	1,250	0.00
14	Anr. 356/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	31.10.13	1,300	1,300	0.00
15	Anr. 358/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	31.10.13	1,350	1,350	0.00
16	Anr. 362/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	31.10.13	1,400	1,400	0.00
17	Anr. 366/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	01.11.13	1,450	1,450	0.00
18	Anr. 367/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	01.11.13	1,500	1,500	0.00
19	Anr. 374/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	01.11.13	500	500	0.00
20	Anr. 388/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	01.11.13	1,550	1,550	0.00
21	Anr. 437/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	04.11.13	1,650	1,650	0.00
22	Anr. 477/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	07.11.13	550	550	0.00
23	Anr. 478/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	07.11.13	500	500	0.00
24	Anr. 480/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	07.11.13	600	600	0.00
25	Anr. 537/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	07.11.13	2,000	2,000	0.00
26	Anr. 592/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	07.11.13	200	200	0.00
27	Anr. 1009/13	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	04.12.13	250	250	0.00
		Total:		36,300	36,300	0.00

28	Anr. 168/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	09.10.13	5,100	5,100	0.00
29	Anr. 171/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	09.10.13	5,150	5,150	0.00
30	Anr. 172/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	09.10.13	5,200	5,200	0.00
31	Anr. 183/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	09.10.13	5,250	5,250	0.00
32	Anr. 185/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	09.10.13	5,300	5,300	0.00
33	Anr. 191/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	09.10.13	5,350	5,350	0.00
34	Anr. 193/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	09.10.13	5,400	5,400	0.00
35	Anr. 194/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	09.10.13	5,450	5,450	0.00
36	Anr. 206/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	17.10.13	800	800	0.00
37	Anr. 207/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	17.10.13	850	850	0.00
38	Anr. 249/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	900	900	0.00
39	Anr. 250/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	950	950	0.00
40	Anr. 258/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	1,000	1,000	0.00
41	Anr. 269/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	5,500	5,500	0.00
42	Anr. 271/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	5,550	5,550	0.00
43	Anr. 274/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	1,050	1,050	0.00
44	Anr. 286/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	1,100	1,100	0.00
45	Anr. 288/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	1,150	1,150	0.00
46	Anr. 290/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	25.10.13	1,200	1,200	0.00
47	Anr. 345/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	31.10.13	1,250	1,250	0.00
48	Anr. 348/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	31.10.13	1,300	1,300	0.00
49	Anr. 349/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	31.10.13	1,350	1,350	0.00
50	Anr. 350/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	31.10.13	1,400	1,400	0.00
51	Anr. 353/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	31.10.13	1,450	1,450	0.00
52	Anr. 355/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	31.10.13	1,500	1,500	0.00
53	Anr. 363/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	31.10.13	1,550	1,550	0.00
54	Anr. 379/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	01.11.13	1,600	1,600	0.00
55	Anr. 381/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	01.11.13	1,650	1,650	0.00
56	Anr. 382/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	01.11.13	1,700	1,700	0.00
57	Anr. 430/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	04.11.13	1,750	1,750	0.00
58	Anr. 431/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	04.11.13	1,800	1,800	0.00
59	Anr. 432/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	04.11.13	1,850	1,850	0.00
60	Anr. 433/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	04.11.13	1,900	1,900	0.00
61	Anr. 434/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	04.11.13	1,950	1,950	0.00
62	Anr. 435/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	04.11.13	2,000	2,000	0.00
63	Anr. 436/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	04.11.13	2,050	2,050	0.00
64	Anr. 489/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	06.11.13	2,100.	2,100	0.00
65	Anr. 591/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	07.11.13	200	200	0.00
66	Anr. 596/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	07.11.13	250	250	0.00
67	Anr. 599/13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	07.11.13	300	300	0.00
		Total:		93,150	93,150	0.00

68	Anr. 152/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	05.10.13	5,100	5,100	0.00
69	Anr. 153/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	05.10.13	5,150	5,150	0.00
70	Anr. 178/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	09.10.13	5,200	5,200	0.00
71	Anr. 179/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	09.10.13	5,250	5,250	0.00
72	Anr. 343/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	31.10.13	5,300	5,300	0.00
73	Anr. 344/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	31.10.13	5,350	5,350	0.00
74	Anr. 371/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	01.11.13	500	500	0.00
75	Anr. 375/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	01.11.13	550	550	0.00
76	Anr. 593/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	07.11.13	200	200	0.00
77	Anr. 595/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	07.11.13	250	250	0.00
78	Anr. 976/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	04.12.13	4,000	4,000	0.00
79	Anr. 1003/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	04.12.13	1,000	1,000	0.00
80	Anr. 1004/13	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	04.12.13	250	250	0.00
		Total:		38,100	38,100	0.00
81	Anr. 177/13	Lëvizja Vetëvendosja (LVV)	09.10.13	800	800	0.00
82	Anr. 408/13	Lëvizja Vetëvendosja (LVV)	04.11.13	250	250	0.00
83	Anr. 594/13	Lëvizja Vetëvendosja (LVV)	07.11.13	200	200	0.00
84	Anr. 1007/13	Lëvizja Vetëvendosja (LVV)	04.12.13	250	250	0.00
85	Anr. 1008/13	Lëvizja Vetëvendosja (LVV)	04.12.13	250	250	0.00
		Total:		1,750	1,750	0.00
86	Anr. 166/13	Aleanca Kosova e Re (AKR)	09.10.13	5,100	5,100	0.00
87	Anr. 298/13	Aleanca Kosova e Re (AKR)	25.10.13	5,150	5,150	0.00
88	Anr. 311/13	Aleanca Kosova e Re (AKR)	25.10.13	800	800	0.00
89	Anr. 352/13	Aleanca Kosova e Re (AKR)	31.10.13	850	850	0.00
		Total:		11,900	11,900	0.00
90	Anr. 246/13	Bashkimi Demokratik (BD)	25.10.13	400	-	400
91	Anr. 247/13	Bashkimi Demokratik (BD)	25.10.13	450	-	450
		Total:		850	-	850
92	Anr. 262/13	G.I Srpska (GIS)	25.10.13	400	400	0.00
93	Anr. 354/13	G.I Srpska (GIS)	31.10.13	550	550	0.00
94	Anr. 425/13	G.I Srpska (GIS)	04.11.13	600	600	0.00
		Total:		1,550	1,550	0.00
95	Anr. 300/13	G.I Narodna Incijativa	25.10.13	400	-	400
		Total:		400	-	400
96	Anr. 333/13	Alternativa Demokratike e Kosovës (ADK)	25.10.13	800	-	800
		Total:		800	-	800
97	Anr. 270/13	Iniciativa Qytetare për Klinë (IQK)	25.10.13	250	-	250
		Total:		250	-	250
98	Anr. 239/13	Iniciativa Qytetare për Malishevë (IQM)	25.10.13	250	-	250
99	Anr. 1005/13	Iniciativa Qytetare për Malishevë (IQM)	04.12.13	250	-	250
		Total:		500	-	500

100	Anr. 386/13	Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)	04.11.13	250	250	0.00
		Total:		250	250	0.00
101	Anr. 281/13	Nova Demokratska Stranka (NDS)	25.10.13	400	400	0.00
		Total:		400	400	0.00
102	Anr. 155/13	Nisma Qytetare për Ferizaj (NQF)	05.10.13	250	250	0.00
103	Anr. 977/13	Nisma Qytetare për Ferizaj (NQF)	04.12.13	250	-	250
		Total:		500	250	250
104	Anr. 320/13	Nisma Qytetare për Prizrenin (NQP)	25.10.13	250	-	250
		Total:		250	-	250
105	Anr. 312/13	Partia e Drejtësisë (PD).	25.10.13	1,000	-	1,000
106	Anr. 377/13	Partia e Drejtësisë (PD).	01.11.13	1,050	-	1,050
107	Anr. 383/13	Partia e Drejtësisë (PD).	01.11.13	1,100	-	1,100
		Total:		3,150	-	3,150
108	Anr. 327/13	Partia Demokratike e Ashkanlive te Kosovës (PDAK)	25.10.13	250	250	0.00
		Total:		250	250	0.00
109	Anr. 479/13	Partia Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK)	07.11.13	200	-	200
		Total:		200	-	200
Totali i përgjithshëm:				190,550	183,900	6,650

Në tabelën me lartë në kolona janë të shënuara të dhënat për Numrin e vendimit, emrin e subjekteve politike, shumën e gjobave të shqiptuara, pagesën e gjobave të shqiptuara dhe gjobat e pa paguara.

14.2 Gjobat e pa paguara të subjekteve politike për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare 2010/11

Nr.	Nr. I vendimit të PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Data e marrjes së Vendimit	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	Anr. 426/10	LDD	23.12.201	2,500	0.00	2,500
2	Anr. 389/10	FER	12.12.2010	1,500	0.00	1,500
3	Anr. 434/10	FER	23.12.2010	1,550	0.00	1,550
Totali i përgjithshëm:				5,550	0.00	5,550

Në Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare të vitit 2010/11 janë mbetur obligime të pa paguara në shumë prej 5,550€. Shumen prej 2,500€ nuk e ka paguar LDD-ja dhe shumën prej 3,050€ nuk e ka paguar FER-i.

14.3 Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur për zgjedhjet lokale 2009/10

Nr.	Nr. I vendimit të PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Data e marrjes së Vendimit	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	Anr.79/10	DRK	23.02.10	1,500	0.00	1,500
2	Anr.83/10	PLK	23.02.10	4,800	0.00	4,800
3	Anr.81/10	RRKPZ	23.02.10	4,800	0.00	4,800
4	Anr.85/10	PRSH	23.02.10	1,500	0.00	1,500
5	Anr.86/10	GIO	23.02.10	500	0.00	500
6	Anr.88/10	SDP	01.03.10	3,200	0.00	3,200
7	Anr.90/10	JSZH	23.02.10	500	0.00	500
8	Anr.91/10	ZBB	23.02.10	500	0.00	500
9	Anr.92/10	ZEG	23.02.10	500	0.00	500
10	Anr.93/10	KP. Bajram Islami	01.03.10	200	0.00	200
11	Anr.95/10	KP. Mexhit Foniqi	01.03.10	200	0.00	200
12	Anr. 97/10	KP. Adem Haxhi Gashi	23.02.10	200	0.00	200
13	Anr. 98/10	KP. Naim Mustafa	23.02.10	200	0.00	200
14	Anr. 99/10	KP. Hasan Bilalli	23.02.10	200	0.00	2000
15	Anr. 100/10	KP. Ahmet Krasniqi	23.02.10	200	0.00	200
Totali i përgjithshëm:				19,000	0.00	19,000

Në Zgjedhjet Lokale të vitit 2009/10, kanë mbetur pa paguar borxhe në shumë prej 19,000€. Në tabelë janë të paraqitura në mënyrë detale për secilin Subjekt Politik. Gjoha të pa paguara kanë mbetur nga vitet 2013 shuma prej 6,650€, ndërsa borxhe të mëhershme kanë mbetur pa u paguar edhe 24,550€. Gjithësejt nga shuma totale e gjobave të shqiptuara kanë mbetur pa u paguar edhe 31,200€.

Gjatë vitit 2013 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 32,700€, ku ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

15 BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Institucioni i PZAP-i si edhe ne te kaluarën edhe gjatë viti 2013, ka pasur dhe vazhdon të këtë bashkëpunimin të mirë me institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, që shpresojmë dhe besojmë se këtë bashkëpunim për arsye te natyrës se punëve dhe mandatit të PZAP-it të përcaktuar me ligj do të vazhdojmë ta ushtrojmë dhe ta kultivojmë edhe ne të ardhmen.

15.1 Bashkëpunimi i PZAP-it me Komisionin Qendror Zgjedhor - KQZ

- Bashkëpunimi i PZAP-it me KQZ-në është i bazuar ne Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës (LZP). Ky bashkëpunim është i përhershëm i arsyeshëm, i nevojshëm dhe i detyrueshëm para, gjatë dhe pas proceseve zgjedhore.
- PZAP-i me Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të KQZ-së, ka bashkëpunuar ngushtë prej fillimit e deri ne përfundimin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale në të gjitha fazat e procesit zgjedhor.
- Bashkëpunimi i PZAP-it me KQZ-në, për te gjitha çështjet që këto dy institucione janë të obliguara sipas LZP-së gjithmonë është bërë përmes shkresave të natyrave të ndryshme siç janë: Kërkesat e PZAP-it për tu përgjigjur në ankesa ndaj vendimeve te KQZ-së, të cilat vendime palët i kanë ankimuar në PZAP, kërkesa për ti ofruar PZAP-it tërë materialin zgjedhor për hetim për Qendrat e Votimit që janë parashtruar ankesa. PZAP-i e ka njoftuar KQZ-në për përfundimin e procesit ankimor dhe vendosjen e të gjitha ankesave nga ana e PZAP-it dhe se KQZ-ja pas këtij konfirmimi nga PZAP-i ka certifikuar rezultatet përfundimtare te Zgjedhjeve Lokale te 3 nëntorit 2013 , PZAP-i e ka njoftuar KQZ-në, për gjobat e paguara dhe të papaguara nga subjektet politike për zgjedhjet paraprake gjë që mundëson KQZ-së certifikimin e subjekteve politike për të garuar në zgjedhjet lokale te 3 nëntorit 2013 si dhe PZAP-i e ka njoftuar KQZ-në, për të gjithë personat të cilët janë dënuar me vendim të PZAP-it që të mos jenë pjesë e stafit administrativ në zgjedhje për periudhën kohore të caktuar në vendim dhe po ashtu të jenë kandidatë të ndonjë subjekti politik.

15.2 Bashkëpunim i PZAP-it, me Policinë e Kosovës

Bashkëpunimi i PZAP-it me Policinë e Kosovës ka qenë prej fillimit e deri në përfundimin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale te 3nëntorit 2013 sa i përket progresit te hetimeve për parregullsitë gjatë procesit zgjedhor dhe sigurisë së procesit zgjedhor. PZAP-i, më Policinë e Kosovës (PK) ka pas një bashkëpunim të mirë. Kërkesat e PZAP-it për PK janë të shumta në numër dhe janë adresuar me qëllim te hetimit te rasteve për parregullsitë gjate fushatës zgjedhore e sidomos për parregullsitë gjatë ditës se votimit me 3 nëntor 2013. PK për gjetjet me rastin e hetimeve për rastet e parregullsive te mundshme ka raportuar PZAP-in me kohe dhe brenda afatit ligjor. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme PZAP-i duhet të vendos

brenda 72 orëve për të gjitha ankesat që lidhen më ditën e votimit, që në shumë raste raporti i policisë është shumë i rëndësishëm për të marr vendim lidhur me ankesën. Policia e Kosovës ka arritur më sukses ti sjell raportet policore nga vendi i ngjarjes brenda afatit të caktuar nga PZAP-i.

15.3 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatën Supreme të Kosovës

Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatën Supreme të Kosovës ka qene lidhur me apelimin e vendimeve te PZAP-it për Zgjedhjet Lokale te 3 nentorit 2013 nga Votuesit Brenda Kosovës dhe nga Votuesit Jashtë Kosovës. PZAP-i i është përgjigjur Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ne kërkesat për përgjigje ne ankesë për te gjitha rastet e ankesave ndaj vendimeve te PZAP-it. PZAP-i me këtë rast përveç përgjigjes me shkrim, Gjykatës Supreme te Republikës së Kosovës i ka bashkëngjitur edhe te gjitha shkresat e lendes lidhur me ankesën.

15.4 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Gjykatat Themelore në Kosovë

PZAP-i gjatë vitit 2013, më Gjykatat Themelore të Kosovë, ka bashkëpunuar lidhur me rastet të cilat janë në procedurë për zgjedhjet paraprake ato Lokale dhe Parlamentare. Në këto raste nga PZAP-i kërkohet që të jetë prezent një përfaqësues i PZAP-it gjatë shqyrtimit kryesor apo kërkohen dëshmi shtesë lidhur më rastet që janë në procedurë. Për të gjitha rastet që janë në procedurë për zgjedhjet paraprake e që kërkohen nga Gjykatat Themelore informata shtesë, PZAP-i ju ofron informata dhe të gjitha dëshmitë që i posedon ky institucion lidhur më rastet.

15.5 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM)

PZAP-i, gjatë vitit 2013, ka bashkëpunuar më KPM-në, për rastet të cilat është pretenduar nga pala ankuese se mediat kanë bërë shkelje gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, ngase sipas ankuesve mediat kanë qenë të njoftuara për mbajtjen e tubimeve publike elektorale por nuk i kanë mbuluar ato prandaj edhe janë ankuar palët e interesuara. Për këto raste PZAP-i, e ka kompletuar lëndën më të gjitha shkresat dhe e ka dorëzuar në KPM-ë për vendosje.

15.6 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Prokurorinë e Shtetit

Bashkëpunimi i PZAP-it, me Prokurorinë e Shtetit ka qenë lidhur me dorëzimin e rasteve që kanë elemente të veprës penale në bazë të KPRK për Zgjedhjet Lokale. PZAP-i, të gjitha rastet të cilat pretendon se kanë elemente të veprës penale i dorëzon në Prokurorinë Shtetërore. Dorëzimi i këtyre rasteve në Prokurorinë e Shtetit bëhet në këtë mënyrë: PZAP-i e përgatit një raport preliminar lidhur më secilin rast, bashkangjet lëndës të gjitha shkresat që lidhen më atë dhe përgatit një shkresë përmbledhës për të gjitha lëndët, pas këtyre procedurave PZAP-i, i dorëzon rastet në Prokurorin Shtetërore. Edhe pas dorëzimit të rasteve në Prokurori PZAP-i prapë bashkëpunon më prokurorin e shtetit lidhur me rastet që janë në procedurë dhe po ashtu edhe prokuroria kërkon informata shtesë nga PZAP-i lidhur më rastet që janë në procedurë

15.7 Bashkëpunimi i PZAP-it, me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE

PZAP-i më OSBE-në ka bashkëpunuar shumë ngushtë gjatë gjithë vitit e me së shumti ky bashkëpunim ka qene gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale. PZAP-i me Zyrtaret e Departamentit për zgjedhje të OSBE-së ka pas takime të rregullta javore në të cilat takime është biseduar dhe trajtuar çështjet aktuale me interes për PZAP-in. Bashkëpunimi i PZAP-it me OSBE-në gjatë vitit 2013 ka qene ne ngritjen e kapaciteteve te personelit te Sekretariatit te PZAP-it kryesisht te Zyrtareve te përhershëm ligjor dhe atyre te përkohshëm, ku për stafin e lartpërmendur i ka mbajtur katër trajnime më këto tema:

- Trajnim për përpilimin e shkresave të ndryshme, në të cilin trajnim janë marr shembuj të ndryshëm për përpilimin e shkresave të natyrave të ndryshme për çështjet e caktuar,
- Trajnimi më temën arsyetimi i vendimeve, në të cilin trajnim janë marr shembuj të ndryshëm se si duhet të arsyetohet një vendim lidhur më çështjen e caktuar,
- Trajnimin lidhur me hetimet në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve, në këtë trajnim është janë shtjelluar çështjet se si duhet të bëhet një hetim në QNR. Në mënyrë praktike janë demonstruar sqarimet se si mund të bëhet një hetim në QNR. Po ashtu është demonstruar në mënyrë praktike se si duhet të jet një kuti e votimit ligjërisht në rregull dhe si nuk duhet të jetë një kuti e votimit ligjërisht në rregull.
- Trajnim lidhur më votimin më postë, në këtë trajnim është trajtuar komplet procedura operacionale se si votohet nëpërmes postes.

Nga trajnimet e lartpërmendura të cilat janë organizuar nga OSBE-ja, PZAP-i ka fituar përvoja të reja në zgjidhjen e ankesave te natyrave të ndryshme prandaj edhe nga PZAP-i është vlerësuar si trajnim i dobishëm.

Gjithashtu bashkëpunimi i PZAP-it me OSBE-ne ka qene edhe ne lehtësimin e procedurës për administrimin e ankesave te votimit përmes postes për ata njerëz (votues) te cilët përkohësisht banojnë jashtë Kosovës te cilët dëshirojnë te ushtrojnë te drejtën e tyre që të paraqesin ankesë kundër vendimit te KQZ-së.

Procesi i administrimit te votimit për Votuesit Jashtë Kosovës ka qene një proces i gjate dhe mjaft sfidues.

Ne lehtësimin e procesit te votimit te Votuesve Jashtë Kosovës për Zgjedhjet e 3 (tre) nëntorit 2013, Personeli i Divizionit te Zgjedhjeve te OSBE-se ankesat e para ka filluar ti dorëzoj ne PZAP me datën 09.10.2013 dhe dorëzimi i ankesave ka zgjatur deri me datën 23.10.2013. Gjate këtij procesi te votimit OSBE ka dorëzuar dhe PZAP- ka pranuar gjithsejte 16410 ankesa.

PZAP-i te gjitha ankesat e pranuar i ka shqyrtuar dhe i ka vendosur brenda afatit ligjor dhe për te njëjtat ankesa ka marre vendime dhe me 16410 vendime i ka njoftuar palët ankuese me lehtësimin e DZ te OSBE-së.

15.8 Bashkëpunim i PZAP-it, me Fondacionin Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES)

Për zgjedhjet lokale 2013, PZAP-i ka bashkëpunuar edhe me IFES-in sa i për ketë informimit publik se si duhet të plotësohet një formularë i ankesës dhe cilat janë parregullsitë zgjedhore për të cilat mund të parashtrahet ankesë në PZAP.

IFES-i, e ka ndihmuar PZAP-in, në informimin e opinionit publik lidhur më plotësimin e formularëve të ankesave, nëpërmes publikimit reklamave në TV, radio, gazetave, portaleve të ndryshmeve si dhe nëpërmes banerave të cilët kanë qenë të vendosur në secilën Qendër të Votimit në ditën e votimit më të cilët janë informuar votuesit se si mund të parashtrahet ankesa në PZAP lidhur më parregullsitë eventuale që mund të hasin gjatë procesit të votimit.

16 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE STATISTIKA PËR ZGJEDHJET LOKALE TË VITIT 2013

PZAP-i, me njëherë pas shpalljes zyrtare të datës së zgjedhjeve, respektivisht caktimit të datës së Zgjedhjeve Lokale, ka filluar zbatimin e planit të punës për këtë proces zgjedhor.

PZAP-i, ka organizuar si zakonisht kujdestarin për këtë proces zgjedhor, respektivisht ka caktuar orarin e punës shtesë për stafin e sekretariatit, për pranimin e ankesave, procedimin dhe vendosjen e tyre nga ana e Panelit prej fillimit të procesit zgjedhor e deri në përfundimin e tij, respektivisht deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve.

Ka mbajtur takime dhe kontakte të rregullta me personin kontaktues të Policisë së Kosovës lidhur me progresin e hetimeve për parregullsitë e pretenduara nga ana e subjekteve politike dhe nga palët e interesuara, gjatë gjithë procesit zgjedhor.

Përgatitja e Formularëve të ankesave në gjuhët zyrtare të Kosovës, shtypja e numrit të mjaftueshëm të këtyre formularëve dhe shpërndarja tyre nëpër të gjitha Qendrat e Votimit (QV).

Konfirmimi i kompletimit të procesit të certifikimit të subjekteve politike dhe pritja e ankesave/apelave dhe vendosja e tyre lidhur me certifikimin e subjekteve politike.

Pritja e ankesave dhe vendosja e tyre nga ana e panelit për fillimin e fushatës para datës së caktuar për fillimin zyrtar të fushatës zgjedhore, gjatë kohës së heshtjes zgjedhore, për ditën e zgjedhjeve, ankesat që kanë të bëjnë me Qendrën e Numërimit të Rezultateve të Zgjedhjeve – QNR.

Konfirmimin për Komisionin Qendror Zgjedhor për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), gjatë procesit të Zgjedhjeve të Lokale, ka kryer me sukses funksionet dhe përgjegjësit e tij të përcaktuar me ligj, ku për

këtë proces zgjedhor te përmendur me lartë në afatin e paraparë ligjor ka vendosur për 1064 ankesa dhe 45 apele, ndërsa për votuesit jashtë Kosovës ka vendosur për 16410 ankesa. Vendosija e te gjitha ankesave nga PZAP-i, në afatet e parapara ligjore i ka mundësuar, Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), certifikimin e rezultateve të Zgjedhjeve Lokale.

16.1 Listat e mëposhtme vërtetojnë ankesat e parashtruara në PZAP nga subjekte te ndryshme sipas Komunave

Numri i ankesave të parashtruara në PZAP sipas komunave për Raundin -I- të zgjedhjeve lokale


Nr.	Komuna	Nr. i ankesave
1	Deçan	30
2	Dragash	2
3	Ferizaj	101
4	Fushë Kosovë	28
5	Gjakovë	29
6	Gjilan	28
7	Glllogovc	11
8	Graçanicë	15
9	Han i Elezit	5
10	Istog	57
11	Junik	4
12	Kaçanik	8
13	Kamenicë	53
14	Klinë	45
15	Klllokotë	1
16	Leposaviq	2
17	Lipjan	74
18	Malishevë	35
19	Mamushë	6
20	Mitrovicë	32
21	Mitrovicë e Veriut	4
22	Novobërdë	11
23	Obiliq	46
24	Partesh	3
25	Pejë	38
26	Podujevë	31
27	Prishtinë	93
28	Prizren	79
29	Rahovec	16
30	Shtërpçë	2
31	Shtime	12
32	Skenderaj	2

33	Suharekë	15
34	Viti	34
35	Vushtrri	101
36	Zubin Potok	1
37	Zveçan	2
Totali:		1056

Numri i ankesave të parashtruara në PZAP sipas komunave për Raundin -II- të zgjedhjeve lokale

Nr.	Komuna	Nr. i ankesave
1	Ferizaj	6
2	Gjakovë	7
3	Gjilan	2
4	Graçanicë	4
5	Lipjan	4
6	Malishevë	1
7	Mitrovicë	4
8	Partesh	1
9	Pejë	2
10	Prishtinë	16
11	Prizren	2
12	Ranillugë	1
13	Suharekë	2
14	Viti	1
Totali:		53

Paraqitja grafike e ankesave të parashtruara në PZAP sipas Komunave gjatë procesit zgjedhor të vitit 2013



17 NATYRA E ANKESAVE TË PARAQITURA NË PZAP GJATË PROCESIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË VITIT 2013

Për Zgjedhjet Lokale të viti 2013, në raundin e parë të zgjedhjeve në PZAP janë paraqitur ankesa të natyrave të ndryshme siç janë:

1. Anulimi i Fletëvotimeve, 6 ankesa;
2. Apele, nga kandidatët e certifikuar për anëtarë të kuvendit komunal të cilët kanë kërkuar të tërhiqen nga lista e certifikuar e subjektit politik, 24 apele;
3. Apele, ndaj vendimeve të PZAP-it, palët e interesuar kanë parashtruar apele për rishikim të vendimit të PZAP-it, 9 apele;
4. Asistim pa leje gjatë votimit, 2 ankesa;
5. Bartja e Materialit Senzitiv pa Polici, 2 ankesa;
6. Bartja e Personave me vetura zyrtare në ditën e votimit për të votuar, 3 ankesa
7. Bartja e votave nga një subjekt politik në tjetrin subjekt politik gjatë ditës së votimit, 6 ankesa;
8. Dëmtim i veturave gjatë mbajtjes së tubimit publik në fushatë zgjedhore, 1 ankesë;
9. Dëmtim i posterave gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, 11 ankesa;
10. Detyrim për të votuar me kusht edhe pse ishte në Listën e Votuesve, 1 ankesë
11. Emërimi i Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), për shkak se palët nuk kanë qenë të kënaqur më emërimet e KKZ-ve, ka parashtruar në PZAP, 7 apele;
12. Ekspozimi i armës afër Qendrës së Votimit (QV), në ditën e votimit, 1 ankesë;
13. Falsifikim i Bexhit për të hyrë në QV, 2 ankesa;
14. Falsifikim i Lapsave Kimik me rastin e plotësimit të Fletëvotimeve, 1 ankesë;
15. Fotografim i Votës, për shkak se në ditën e votimit i kanë fotografuar votat, 9 ankesa;
16. Fushatë Zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, 4 ankesa;
17. Fyerje, sharje dhe shpifje, gjatë procesit të votimit, 10 ankesa;
18. Grafite në pronë private gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, 1 ankesë;
19. Hedhje e votës me kusht në kutinë e votave të rregullta, 1 ankesë;
20. Keqpërdorim i votave gjatë procesit të numërimit sepse nuk janë regjistruar votat në Formularin e Përputhjes së Rezultateve (FPR), 61 ankesa;
21. Kërcenim dhe shantazh gjatë procesit të votimit, 3 ankesa;
22. Libri i Votimit ka munguar në Vendvotim, 1 ankesë;
23. Manipulim me Vota, këto janë ankesa të cilat i kanë parashtruar në PZAP, kandidatet për anëtarë të kuvendeve komunale të cilët kanë theksuar në ankesat e tyre se janë manipuluar votat, për pa theksuar se në çfarë mënyre janë manipuluar ato vota, 109 ankesa;
24. Materiali me përmbajtje të fushatës zgjedhore në Vendvotim në ditën e votimit, 1 ankesë;
25. Mbajtja e tubimeve publike nga subjektet politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, për pa e paralajmëruar Komisionin Komunal Zgjedhor (KKZ), 14 ankesa;
26. Mbulim i posterave të ndryshëm me përmbajtje garuese në zgjedhje gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, 46 ankesa;
27. Me pak fletëvotime në një Vendvotim se sa votues në Vendvotim, 1 ankesë;
28. Media nuk i kanë mbuluar tubimet publike, edhe pse subjekti politik i ka ftuar mediat në mbajtjen e tubimit publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, ato nuk

kanë marr pjesë në tubime, 2 ankesa;

29. Menaxheri i Qendrës së Votimit (QV), ish i akuzuar, 1 ankesë;
30. Më shumë fletëvotime në kutinë e votimit se sa nënshkrime në Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV), 1 ankesë;
31. Mos përsëritja e votimit edhe pse janë anuluar votat në disa QV nga KQZ-ja, 1 ankesë;
32. Mospërputhje të votave në mes të votave në Formularin e Përputhjes së Rezultateve të Kandidatëve dhe publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, 202 ankesa;
33. Mungesa e votave me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar me atë të cilin e posedojnë vëzhguesit gjatë ditës së votimit, 4 ankesa;
34. Mungojnë votat e familjarëve dhe të afërmeve tjerë me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, 94 ankesa;
35. Ndërprerja e rrymës me qëllim të vjedhjes së votave në ditën e votimit, 4 ankesa;
36. Ndërrim i numrit në listën e kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal për pa u njoftuar kandidati, 1 ankesë;
37. Ndërrim i Qendrës së Votimit pa u njoftuar qytetaret, 1 ankesë;
38. Nuk janë publikuar votat siç ishin në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK), 5 ankesa;
39. Numri i fletëvotimeve të përdorura nuk është në përputhje me numrin e votuesve, 2 ankesa;
40. Numri i votave të publikuara nuk është i njëjtë me atë që e posedojnë vëzhguesit apo nuk korrespondon me numrin e votave të fituara, 15 ankesa;
41. Ofendime gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, 2 ankesa;
42. Parregullsi gjatë procesit të votimit, 58 ankesa;
43. Parregullsi gjatë nominimit të komisionerve, 1 ankesë;
44. Pengim në punën e komisionerve në ditën e votimit, 2 ankesa;
45. Pengim gjatë mbajtjes së tubimit publik, në periudhën e fushatës zgjedhore, 4 ankesa;
46. Për mos regjistrimin e subjektit politik nga KQZ-ja, 3 apele;
47. Për të hyrë në listën e votuesve, 1 ankesë;
48. Përdorimi i fëmijëve në tubime publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, 2 ankesa;
49. Përleshje fizike, 6 ankesa;
50. Personave me aftësi të kufizuara nuk ju kanë mundur kushtet për të votuar, 1 ankesë;
51. Personat e vdekur janë gjetur në listat e votuesve, në ditën e votimit, 2 ankesa;
52. Posterit me përmbajtje të fushatës zgjedhore i cili gjindej me afër se 100 metra nga Qendra e Votimit në ditën e votimit, 9 ankesa;
53. Premtime financiare gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, 4 ankesa;
54. Presion ndaj votuesve për ta votuar subjektin e caktuar politik në ditën e votimit, 16 ankesa;
55. Publikimi i dezinformative në Facebook, 1 ankesë;
56. Qëndrimi i personave pa autorizim në Qendrën e Votimit në ditën e votimit, 3 ankesa;
57. Shpërndarja e ulëseve në kuvend komunal, 10 ankesa;
58. Shpërndarja e miellit në ditën e votimit me qëllim të përfitimit të votave, 1 ankesa;

59. Thyerje e Heshtjes Zgjedhore, 17 ankesa;
60. Vendosja e posterave në prona private, 2 ankesa;
61. Vendosja e posterave dhe flamujve të subjekteve politike në vetura private në ditën e votimit, 4 ankesa;
62. Vendosja e posterave mbi rrugë publike, 49 ankesa;
63. Vendosja e posterave në objekte publike, 61 ankesa;
64. Vendosja e posterave në shenjat e komunikacionit, 33 ankesa;
65. Vjedhja e votave përbrenda subjektit politik, 59 ankesa;
66. Vjedhje e votave për pa e specifikuar kryerësin e supozuar, 10 ankesa;
67. Votat e vlefshme janë shpallur të pavlefshme, 1 ankesë;
68. Votim Familjar, 1 ankesë;
69. Votim i dyfishtë, 12 ankesa;
70. Votim pa dokumente valide, 3 ankesa;
71. Votim në emër të dikujt tjetër, 2 ankesa;
72. Votim në emër të personit të vdekur, 1 ankesë;
73. Votuesi gjen rubrikën e tij në LPV te plotësuar, 2 ankesa dhe
74. Votuesit nuk ju ka mundur të votoj sepse në gishtrinë ka pas shenja të cilat kanë treguar se ka votuar, 5 ankesa.

Siç shihet nga të dhënat e sipërshënuara PZAP-i gjatë procesit të zgjedhjeve lokale të vitit 2013 ka vendosur për 74 lloje të natyrave të ndryshme të ankesave dhe apele vetëm në raundin e parë të zgjedhjeve.

Për Zgjedhjet Lokale të vitit 2013, në raundin e dytë të zgjedhjeve në PZAP janë paraqitur ankesa të natyrave të ndryshme siç janë:

1. Asistim për të votuar, 2 ankesa;
2. Blerje e votës, 2 ankesa,
3. Dhënia e udhëzimeve votuesve për kë të votojnë, 1 ankesë;
4. Falsifikim i fletëvotimeve, 2 ankesa;
5. Fotografim i Votës, për shkak se në ditën e votimit i kanë fotografuar votat, 8 ankesa;
6. Fyerje përmes Facebook, 2 ankesa;
7. Hyrja e personave të pa autorizuar në Qendrën e Votimit, 3 ankesa;
8. Një rast PZAP-i e ka dorëzuar në KPM, 1 akt përcjellës;
9. Kërcenim dhe shantazh gjatë procesit të votimit, 3 ankesa;
10. Mungesa e një fletë në LPV, 1 ankesë;
11. Ndërrim i lokacionit të QV-së, pa u njoftuar votuesit, 1 ankesë;
12. Nuk ju është lejuar një vëzhguesi të marr pjesë gjatë numërimit në një

vendvotim, 1 ankesë;

13. Përdorimi i veturave zyrtare në ditën e votimit, 3 ankesa;

14. Pengim gjatë mbajtjes së tubimit publik, 1 ankesë;

15. Personat (emrat) e vdekur janë gjetur në LPV, 2 ankesa;

16. Shkatërrimi i materialit zgjedhor, 2 ankesa;

17. Thyerje e Heshtjes Zgjedhore, 6 ankesa;

18. Vendosja e posterave në objekte publike, 5 ankesa;

19. Vendosja e posterave me afër se 100 metra nga QV-ja në ditën e votimit, 3 ankesa;

20. Votim me dokumente jo valide, 1 ankesë;

21. Votim në emër të dikujt tjetër, 1 ankesë dhe


22. Votim publik, 2 ankesa.

Siç shihet nga të dhënat e sipërshënuara PZAP-i gjatë procesit të zgjedhjeve lokale të vitit 2013 ka vendosur për 22 lloje të natyrave të ndryshme të ankesave dhe apele vetëm në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale.


17.1 Numri ankesave të parashtruar në PZAP për të dy raundet në zgjedhjet lokale të vitit 2013 nga subjekte të ndryshme

Nr.	Emri i subjektit që ka parashtruar ankesë	Numri i ankesave	Numri i apeleve
1	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	40	1
2	Aleanca Kosova e Re (AKR)	18	1
3	Bashkimi Demokratik (BD)	13	
4	Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)	27	
5	G.I. Srpska	8	1
6	Iniciativa Kroate e Kosovës (HSK)		1
7	Iniciativa Qytetare e Drenasit (IQD)	1	1
8	Iniciativa Qytetare për Malishevë (IQM)	2	
9	Kandidat të Pavarur për Kryesues Komune	8	
10	Kandidat të Certifikuar në lista të subjekteve politike		23
11	Kandidat për Anëtarë të Kuvendit Komunal	488	6
12	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)	10	
13	Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)	4	
14	Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ)	1	1
15	Komuna e Graçanicës	6	
16	Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP)	7	1
17	Kosova Turk Birligi (KTB)	2	
18	Kryesues të Vendvotimeve (KVV)	2	
19	Lëvizja për Bashkim (LB)	1	
20	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	84	3
21	Lëvizja për Integrim dhe Zhvillim (LIZH)	1	
22	Lëvizja Vetëvendosja (LVV)	155	2
23	Nova Demokratska Stranka (NDS)		1
24	Nisma Qytetare për Prizrenin (NQP)	2	
25	Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI)	11	
26	Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK)	3	
27	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	127	1
28	Partia Tradicionale e Kosovës (PTSH)		1
29	Stranka Demokratske Akcije (SDA)	1	
30	Sfinga	1	1
31	Savez Kosovskih Srba (SKS)	4	
32	Samostalna Liberalna Stranka (SLS)	8	
33	Srpska Narodna Partija Kosova (SNPK)	2	
34	Të pavarurit e Mitrovicës	2	
35	Koalicija Vakut	3	
36	Vëzhgues	4	
37	Votues	9	
38	Zyrtar i Lartë i Komisionit Komunal Zgjedhor	9	
Totali:		1064	45

Paraqitja grafike e ankesave të parashtruar në PZAP për të dy raundet në zgjedhjet lokale të vitit 2013 nga subjekte të ndryshme



**Paraqitja grafike e apeleve të parashtruar në PZAP për të dy raundet
në zgjedhjet lokale të vitit 2013 nga subjekte të ndryshme**




17.2 Numri i ankesave të parashtruara në PZAP nëpër secilën fazë të procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të vitit 2013:

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur ankesat e parashtruara në PZAP sipas fazave të procesit zgjedhor për raundin e -I-

Nr.	Fazat e procesit zgjedhor	Numri i ankesave	Numri i apeleve
1	Para fillimit të Fushatës Zgjedhore	4	27
2	Gjatë periudhës së Fushatës Zgjedhore	242	10
3	Për Thyerjen e Heshtjes Zgjedhore	22	2
4	Ankesat lidhur me ditën e votimit	217	
5	Ankesat lidhur me Rezultatet Preliminare "K-Vote" për Kandidatet për Anëtarë të Kuvendit Komunal	245	
6	Ankesat lidhur me Rezultatet Përfundimtare për Kandidatet për Anëtarë të Kuvendit Komunal	276	6
7	Ankesat lidhur me Kandidatet për Kryesues Komune	5	
Totali		1011	45


Paraqitja grafike e apeleve të parashtruara në PZAP nëpër secilën fazë të procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të vitit 2013:



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur ankesat e parashtruara në PZAP sipas fazave të procesit zgjedhor për raundin e -II-

Nr.	Fazat e procesit zgjedhor	Numri i ankesave	Numri i apeleve
1	Para fillimit të Fushatës Zgjedhore	2	
2	Gjatë periudhës së Fushatës Zgjedhore	6	
3	Për Thyerjen e Heshtjes Zgjedhore	8	
4	Ankesat lidhur me ditën e votimit	37	
Totali		53	


Paraqitja grafike e ankesave të parashtruara në PZAP nëpër secilën fazë të procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të vitit 2013:




17.3 Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat tregojnë për secilën ankesë çfarë vendimi ka marr PZAP-i, për raundin -I- të zgjedhjeve lokale

Nr.	Vendimmarrja nga PZAP-i lidhur me ankesat e parashtruara gjatë procesit zgjedhor	Ank-esat	Ap-elet
1	Numri i ankesave që nuk kanë qenë nën juridiksionin e PZAP-it	2	
2	Numri i ankesave/apelve për të cilat PZAP-i, ka vendosur se janë të palejuara	242	34
3	Numri i ankesave/apelve për të cilat PZAP-i, ka vendosur se janë të parregullta	24	1
4	Për një ankesë PZAP-i, ka vendosur se është çështje e gjykuara (res judicata)	1	
5	Në një rast PZAP-i sipas detyrës zyrtare e ka korrigjuar vendimin e tij	1	
6	Numri i ankesave të bazuara dhe që kanë rezultuar me gjoba	101	
7	Një ankesë për të cilën PZAP-i, ka vendosur se është bazuar dhe që kanë rezultuar me rivotim	1	
8	Numri i ankesave të bazuara dhe që kanë rezultuar me rinumërim	21	
9	Për dy apele PZAP-i, ka vendosur se janë të bazuara dhe që kanë rezultuar me prishjen e vendimit të KQZ-së		2
10	Numri i ankesave për të cilat PZAP-i, ka vendosur se janë të pabazuara për shkak të mungesës së provave	552	8
11	Numri i kërkesave për tërheqje të ankesave	66	
Totali:		1011	45

Paraqitja grafike e ankesave sipas mënyrës së marrjes së vendimeve ndaj tyre për raundin e -I-




Paraqitja grafike e apeleve sipas mënyrës së marrjes së vendimeve ndaj tyre



Nr.	Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat tregojnë që për secilën ankesë çfarë vendimi ka marr PZAP-i, për raundin -II- të zgjedhjeve lokale	Ankesat	Apele
1	Numri i ankesave që nuk kanë qenë nën juridiksionin e PZAP-it	1	
2	Numri i ankesave/apelveve për të cilat PZAP-i, ka vendosur se janë të palejuara	5	
3	Për një ankesë PZAP-i, ka vendosur se është e parregullt	1	
4	Për një ankesë PZAP-i, ka vendosur se është çështje e gjykuar (res judicata)	1	
5	Për një ankesë PZAP-i, e ka vendosur si të bazuar e cila ka rezultuar që një personi ti ndalohet të merr pjesë në zgjedhje si kandidat dhe si pjesë administrative për dy vite	1	
6	Numri i ankesave të bazuara dhe që kanë rezultuar me gjoba	8	
7	Numri i ankesave për të cilat PZAP-i, ka vendosur se janë të pabazuara për shkak të mungesës së provave	36	
Totali:		53	

Paraqitja grafike e ankesave sipas mënyrës së marrjes së vendimeve ndaj tyre për raundin e -II-



18 RASTET E DËRGUARA NË PROKURORINË E SHTETIT

Me rastin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga palët e interesuara dhe vendosjes së tyre, në Zgjedhjet Lokale të 3 nëntorit 2013, PZAP-i, ka identifikuar disa ankesa në të cilat ka pasur pretendime ankimore me elemente të veprës penale.

Janë gjithsej 64 raste të identifikuara nga PZAP-i, te cilat i ka dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Natyra e ankesave të dorëzuara ne Prokurorinë Shtetërore nga PZAP-i, janë si në vijim:

- Përleshje fizike,
- Fyerje,
- Sulm,
- Nënshkrim në emër të dikujt tjetër,
- Pengim në punën e komisionerve,
- Ekspozim i armës afër QV në ditën e votimit,
- Kërcenim dhe shantazh,
- Votim i dyfishtë,
- Presion ndaj votuesve,
- Presion për të nënshkruar në librin e vërejtjeve,
- Premtim i shpërblimit financiar,
- Falsifikim i bexhit,
- Fotografim i votës,
- Më shumë fletëvotime në Kutinë e votimit sesa nënshkrime,
- Mungesë e votave me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar me atë të cilën e posedojnë vëzhguesit,
- Anulim i fletëvotimeve,
- Manipulim me vota,
- Mospërputhje të votave në mes të FRK-ve dhe publikimit të rezultatit përfundimtar,
- Mosregjistrim i votave në FRK,
- Keqpërdorim të votave gjatë procesit të numërimit,
- Parregullsi gjatë procesit të votimit,
- Bartje e votave nga një subjekt tjetër politik,
- Ndikim tek votuesit,
- Shkëputja e fletëvotimeve para se me ardh votuesit,
- Votim në emër të dikujt tjetër,
- Vjedhje e votave përbrenda subjektit politik,
- Shkatërrim i materialit zgjedhor,
- Transporti i qytetarëve për të votuar,
- Asistim për të votuar,
- Mungesë e votave të familjarëve.

19 PADITË E PARAQITURA NDAJ VENDIMEVE TË PZAP-IT NË GJYKATËN SUPREME

Gjatë Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013, palët e pa kënaqura me vendimet e PZAP-it kanë ushtruar të drejtën e tyre ligjore dhe i kanë apeluar vendimet e PZAP-it në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, gjithsej 48 vendime janë ankimuar në Gjykatën Supreme, prej të cilave 47 padi janë refuzuar dhe 1 (një) padi është miratuar.

Natyrat e këtyre vendimeve të PZAP-it të cilat janë ankimuar në Gjykatën Supreme, janë si në vijim:

- Mos regjistrim i subjektit politik PTSH nga KQZ-ja,
- Apel për tërheqje nga lista e kandidatëve të certifikuar,
- Vendosja e posterave në shenja publike të trafikut,
- Mbulim posterash,
- Vendosja e posterave në objekte publike,
- Shpërndarja e vendeve në Kuvende Komunale,
- Premtime gjatë fushatës,
- Thyerje e heshtjes zgjedhore,
- Manipulim me vota,
- Mospërputhje të votave në mes të FRK dhe publikimit të rezultatit përfundimtar,
- Parregullsi gjatë procesit të votimit,
- Mungesë e votave të familjarëve,
- Vjedhje e votave përbrenda subjektit politik,
- Shpërndarja e ulëseve në Kuvend,
- Publikim jo real i rezultateve përfundimtare.

20 ANKESAT E PRANUARA NË PZAP NGA VOTUESIT JASHTË KOSOVËS

Ankesat nga votuesit jashtë Kosovës ka qenë një sfidë e re për institucionin e PZAP-it ngase deri në zgjedhjet lokale të vitit 2013, PZAP-i nuk ka pranuar asnjëherë ankesa nga votuesit jashtë Kosovës apo ankesa të kësaj natyre.

PZAP-i, gjatë të procesit zgjedhor ka pranuar 16410 ankesa nga votuesit jashtë Kosovës, të cilat ankesa janë parashtruar në PZAP, si rezultat i refuzimit të aplikacioneve nga ana Komisionit Qendror Zgjedhor lidhur me mos plotësimin e kriterëve të parapara sipas ligjslacionit në fuqi, të cilët me ankesat e tyre kanë kërkuar që të ju jepet e drejta për të votuar në zgjedhjet lokale të vitit 2013 siç parashihet në LZP.

Kjo ishte një sfidë për institucionin e PZAP-it nga siç dihet afatet ligjore për të vendosur lidhur me këto ankesa të lartpërmendura është 72 orë.

Procesi i Votimit Jashtë Kosovës, pranimi i ankesave dhe dorëzimi/njoftimi i paleve me vendime është bërë me lehtësimin e personelit të Divizionit të Zgjedhjeve të OSBE-se.

PZAP-i, ka pranuar grumbuj të ankesave nga 100 deri në 5600 të Votuesve Jashtë Kosovës në intervale të ndryshme kohore nga data 09.10.2013 deri me datën 23.10.2013. Varësisht prej kohës se grumbujve të pranuar të këtyre ankesave është dashtur që brenda 72 orëve stafi i administratës të përgatit të gjitha materialet e nevojshme për seance dhe paneli të vendos lidhur me këto ankesa. Ankesat këtu qenë të futura në zarfa, zarfat është dashtur që të hapen dhe të shkruhen në mënyrë elektronike të dhënat për identitetin e ankuesve nga personeli i sekretariatit të PZAP-it.


Vendosja e 16410 ankesave nga ana e panelit, dhe njoftimi i paleve ankuese me 16410 vendime ka qenë një proces shumë i vështirë dhe i ndërlikuar, por që me angazhimin dhe perkushtimin e gjithë personelit të sekretariatit të PZAP-it atij permanent dhe jo permanent si dhe të anetareve të PZAP-it me sukses është përballuar dhe është tejkaluar ky proces i votimit të Votuesve Jashtë Kosovës.

PZAP-i për të vendosur për 16410 ankesa ka organizuar 22 panele, gjë që ka vendosur për të gjitha ankesat brenda afateve parapara ligjore, prej të cilave:

- Për 54 ankesa ka vendosur se janë të pasafatshme;
- Për 353 ankesa ka vendosur se janë të parregullta;
- Për 5458 ankesa ka vendosur se i plotësojnë kushtet për të votuar dhe i ka miratuar si të bazuara;
- Për 10419 ankesa ka vendosur se nuk kanë dëshmi të mjaftueshme dhe i ka refuzuar si të pabazuara;
- Për 124 ankesa ka vendosur se janë çështje të gjykuar (res judicata), ngase palët e interesuar kanë parashtruar ankesa për të njëjtën natyrë, në të njëjtën kohë dhe me të njëjtat dëshmi nga dy po tri herë prandaj edhe PZAP-i nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e këtyre ankesave;
- Për 2 ankesa PZAP-i nuk ka vendosur fare ngase formulari i ankesës ka qenë i zbrazët dhe vetëm ishte i futur në kovertë.

20.1 Paraqitja grafike e ankesave nga votuesit jashtë Kosovës

Ankesat e pranuar në PZAP nga votuesit jashtë Kosovës



21 MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT

në mes te

Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillit Prokuroria të Kosovës (KPK), Policisë së Kosovës (PK), Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Duke u nisur nga parregullsitë e ndodhura gjatë procesit të kaluar zgjedhor për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Parlamentare të mbajtura në vitin 2010, me qëllim të parandalimit të parregullsive që mund të ndodhin në zgjedhjet e ardhshme lokale që do të mbahen më 3 nëntorit 2013 nën udhëheqjen e Prokurorit të Shtetit, me pëlqimin institucioneve bartëse të përgjegjësive së procesit zgjedhor dhe të atyre që në mënyrë indirekte janë të lidhura me përgjegjësi ligjore lidhur me këtë proces me datën 18.09.2013, është miratuar Memorandumi i Mirëkuptimit (MiM) në mes të KGJK-së, KPK-së, PK-së, KQZ-së dhe PZAP-it, i cili MiM është hartuar dhe miratuar në pajtim me Ligjet e aplikueshme që rregullojnë mandatin e Institucioneve të lartpërmendura.

Këto Institucione në bazë të nenit 8 pika 1 e këtij MiM, obligohen që të harmonizojnë dhe koordinojnë planet e veprimit për të gjitha aktivitetet për procesin Zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale të 3 nëntorit 2013.

Plani i veprimit për Zgjedhjet Lokale të 3 nëntorit 2013, do të përfshijë aktivitete dhe veprimet procedurale si dhe çështjet tjera që ndërlidhen në mes të PZAP-it dhe këtyre Institucioneve që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor nga shpallja zyrtare e Zgjedhjeve Lokale deri në përfundimin e këtyre rasteve nga Gjykatat.

Plani i veprimit ka për qëllim që të gjitha aktivitetet dhe veprimet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor nga Institucionet nënshkruese të këtij MiM të koordinohen dhe harmonizohen në at mënyrë që procesi zgjedhor i Zgjedhjeve Lokale të 3 nëntorit 2013, të jetë sa më i suksesshëm.

Edhe në të kaluarën të gjitha këto institucione në mes vete kanë pasur bashkëpunim të mirë me çka kanë arritur që të gjitha çështjet, rastet të procedojnë në mënyrën sa më të mirë të mundshme, por ky Memorandum dhe planet e veprimit që do të hartohen dhe miratohen nga këto institucione palë në këtë memorandum do të lehtësoj bashkëpunim dhe do të mundësoj koordinimin e tyre më të mirë në mënyrë që procesi zgjedhor i zgjedhjeve të 3 nëntorit 2013 të kalojë sa më pak parregullsi dhe të jetë i suksesshëm.

Koordinimi i aktiviteteve në mes të PZAP-i dhe KQZ-së

PZAP-i, koordinon dhe harmonizon aktivitetet me KQZ-në, gjatë gjithë procesit zgjedhor prej shpalljes zyrtare të zgjedhjeve e deri të shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve:

- **Regjistrimi i Partive Politike dhe Certifikimin e Subjekteve Politike**, (Partive Politike, Iniciativave Qytetare, Kandidateve të Pavarur). Subjektet Politike për të marrë pjesë në zgjedhje fillimisht duhet të kandidojnë (aplikojnë) për tu certifikuar në KQZ. KQZ-ja – ZRPPC-ja, me pranimin e aplikacionit nga subjekti politik, kërkon nga PZAP-i, konfirmimin me shkrim për subjektin politik që ka aplikuar se a i ka paguar të gjitha gjordat në lidhje me cilat do zgjedhje të më parme dhe të konfirmoj se nuk ka borxhe tjera të papaguara. KQZ-ja

- ZRPPC-ja, kërkon nga PZAP-i, konfirmimin me shkrim për emrat dhe mbiemrat e personave të ndalur me vendime të PZAP-it, që të janë kandidatë apo pjesë përbërëse e stafit administrativ në zgjedhje që menaxhohen nga KQZ-ja dhe PZAP-i është i obliguar që ta përmbush këtë detyrë.
- **Akreditimi i Vëzhguesve të zgjedhjeve**, Çdo individ ose organizatë që ka aplikuar për certifikim për vëzhgim të procesit zgjedhor e që i është mohuar akreditimi nga KQZ-ja mund të parashtrij apel në PZAP dhe PZAP-i është i obliguar të vendos për apelin brenda 72 orëve.
- **Votimi Jashtë Kosovës - Konfirmimi dhe Procesi i Ankesave**, KQZ-ja njofton kandidate që kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës, nëse aplikimi i tij/saj është pranuar ose refuzuar. Ndaj vendimit të KQZ-së për refuzim të aplikimit kandidati që ka aplikuar ka të drejtë të bëjë ankesë në PZAP.
- **Dorëzimi i Formularëve të Ankesave**: PZAP-i kërkon ndihmën e KQZ-së që gjatë shpërndarjes së materialit për zgjedhje nga ana e KQZ-së neper Qendra të Votimit (QV) dhe Vendvotime (VV) të shpërndaj edhe Formularët e Ankesave në mënyrë që votuesit të kenë mundësi të paraqesin ankesat e tyre lidhur me parregullsitë që mund të ndodhin gjatë ditës së votimit.
- **Qendra e Numrit dhe Rezultateve – QNR**, PZAP-i bashkëpunon me QNR në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QNR.
- **Certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve**. PZAP-i bashkëpunon me KQZ-në lidhur me certifikimin e zgjedhjeve. Pas përfundimit të procedurave ankimore në Vendvotime dhe në Qendrat e Numërimit nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme, KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve Lokale të 3 nëntorit 2013.
- **Ankesa që kanë të bëjnë me mos deklarin e raportit financiare të fushatës zgjedhore për raundin e parë dhe të dytë**. Nëse një subjekt politik nuk e dorëzon Raportin e Publikimit Financiar të fushatës deri në afatin përfundimtarë ose, dorëzon raport jo të plote dhe të pasaktë, ZRPPC, paraqet ankesë në PZAP, 45 dite pas ditës së zgjedhjeve lokale të 3 nëntorit 2013.
- **Koordinimi dhe bashkëpunimi lidhur me shkatërrimin e materialit zgjedhor sipas afateve të përcaktuara me ligj**. KQZ-ja me një vendim pas certifikimit zyrtar të rezultatit të zgjedhjeve shkatërron materialet e zgjedhjeve brenda 60 ditëve, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga PZAP-i.

Koordinimi i aktiviteteve në mes të PZAP-i dhe Policisë së Kosovës (PK)

- **Bashkëpunimi i PZAP-it me Policinë e Kosovës**. PZAP-i kërkon ndihmë e Policisë së Kosovës gjatë gjithë procesit zgjedhor e në veçanti gjatë fushatës zgjedhore dhe ditës së votimit për hetimin e rasteve të paraqitura përmes ankesave nga individë dhe subjekte politike për parregullsitë që pretendohet se kanë ndodhur gjatë procesit zgjedhor.
- **Caktimi i personave kontaktues PZAP-i - Policia e Kosovës**. Me qëllim të lehtësimit dhe koordinimit me të mirë të punës në mes të PZAP-it dhe PK nga të dy Institucionet duhet të caktohen nga një ose më shumë personat kontaktues të cilët do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën lidhur me rastet e ankesave që kanë të bëjnë me elemente për hetim

ne rast te kanosje, kërcënimeve pengimit te aktiviteteve te ndryshme zgjedhore, pengimit te tubimeve elektorale dhe parregullsi tjera gjatë ditës se votimit etj.

- **Dërgimi i ankesave nga PZAP-i ne Policinë e Kosovës dhe kthimi i raportit lidhur me ankesat ne PZAP nga ana e Policisë.** Personi kontaktues i PZAP-it do ti adreson përmes postes elektronike te gjitha ankesat dhe shkresat e lendes te skanuara te personat kontaktues te Policisë së Kosovës te cilët obligohen qe këto ankesa bashke me materialet tjera përcjellëse ti pranojnë dhe t'i procedon për kompetence te mëtejme për shqyrtimin e tyre brenda Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës pas shqyrtimit te rasteve obligohet që PZAP-in ta informoj përmes personit kontaktues me një raport te shkruar lidhur me progresin e hetimeve për pretendimet ankimore.

Koordinimi i aktiviteteve ne mes te PZAP-i dhe Këshillit Prokuroria te Kosovës (KPK)

- **Dorëzimi procedimi i rasteve me elemente te veprës penale nga PZAP-i ne Prokurorin e Shtetit.** PZAP-i obligohet që te procedoj në KPK, respektivisht ne Prokurorin e Shtetit të gjitha ankesat se bashku me shkresat përcjellëse te lendes nëse PZAP-i konsideron se ka elemente te Veprës Penale. Sipas LZP-së, vendimi për caktimi i një gjobe apo ndonjë sanksione tjetër nga PZAP-i, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksioni penal qe mund te pasoj. PZAP-i gjate shqyrtimit te ankesave ne baze te pretendimeve ankimore dhe shkresave te lendes mund te konstatoj se ne ato ankesa ka elemente te përgjegjësisë individuale që individ te caktuar kane abuzuar ne mënyra te ndryshme gjatë procesit zgjedhor e që ato vepra penale janë të ndëshkueshme me Kodin e Ri Penal të Republikës së Kosovës. PZAP-i te gjitha rastet e përmendura me lartë i dërgon në KPK jo me vone se 45 dite pas certifikimit te rezultateve përfundimtare te zgjedhjeve për zgjedhjet Komunale te 3 nëntorit 2013. PZAP-i obligohet që deri ne përfundimin e plote te shqyrtimit te këtyre rasteve nga Prokuroria ti ofroj te gjitha materialet qe Prokuroria kërkon për këto dhe raste tjera lidhur me këtë proces zgjedhor. Do te ishte me interes qe Prokuroria e Shtetit t'i mbaje te informuara institucionet nënshkruese te këtij MiM me rezultatet e hetimit për te gjitha rastet e dorëzuara ne Prokurori për zgjedhjet Komunale te 3 nëntorit 2013.

Koordinimi i aktiviteteve ne mes te PZAP-i dhe Këshillit Gjyqësor te Kosovës (KGJK-së)

- PZAP-i, obligohet qe Gjykatës Supreme ti ofroj te gjitha shkresat e lendes për vendosje ne shkalle te dyte lidhur me Apelimet qe palët parashtrajnë ne këtë Gjykate si dhe obligohet qe Gjykatave kompetente ti ofroj prova te nevojshme materiale nëse këto gjykata i kërkojnë nga PZAP-i për vendosjen e lendeve te dorëzuara ne Gjykata lidhur me kallëzimet penale qe ka ngritur Prokuroria e Shtetit. Do te ishte me interes qe KGJK-ja t'i mbaje te informuara institucionet nënshkruese te këtij MiM me dënimet e shqiptuara ndaj kryerësve te veprave penale për zgjedhjet Komunale te 3 nëntorit 2013.

Akteret e këtij MiM, obligohen te zbatojnë aktivitetet dhe veprimet e përfshira ne këtë MiM, por jo ne mënyrë te kufizuar për arsye se mund te dalin aktivitetet tjera shtese e qe janë te detyrueshme për ti zbatuar.

Rekomandimet e PZAP-it lidhur më sfidat gjatë bashkëpunimit më institucionet tjera gjatë procesit zgjedhor të vitit 2013.

Vështirësitë dhe sfidat e bashkëpunimit të PZAP-it më KQZ.

Bashkëpunimi i PZAP-it më KQZ-në, gjatë gjithë procesit zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale të 3 nëntorit 2013 ka qenë i mirë. Bashkëpunimi i PZAP-it më KQZ, është lidhur më sigurimin e materialit apo të shkresave të cilat PZAP-i i kërkon në rastet kur ka ankesë lidhur më ndonjë çështje që është palë edhe KQZ-ja. Në shumicën e rasteve KQZ-ja i ofron informatat e kërkuara PZAP-it brenda afatit të caktuar ngase siç dihet afatet ligjore për vendosur për ankesat që lidhen më ditën e votimit dhe apelet që parashtrohen ndaj vendimeve të KQZ-së, janë mjaft të limituar, prandaj edhe kërkohet nga KQZ-ja që sa më shpejt që është e mundur ti kthen PZAP-it përgjigje lidhur më atë që është kërkuar. Sfida më e madhe në vitin e kaluar ka qenë më ankesat të cilat kanë pas të bënë më Votuesit Jashtë Kosovës, ku PZAP-i ka kërkuar nga KQZ-ja të përgjigjet në lidhje më ankesat e parashtruar ndaj vendimeve të sa, por KQZ-ja nuk ka mundur ti ofroj PZAP-it informatat e kërkuara lidhur më rastet e parashtruar kjo ka qenë një vështirësi për PZAP-in, andaj edhe rekomandojmë që në të ardhmen mos të përsëritën vonesat në kthimin e përgjigjeve sa i për ketë rasteve të caktuar.

Vështirësitë dhe sfidat e bashkëpunimit të PZAP-it më Policinë e Kosovës

Bashkëpunimi i PZAP-it më Policinë e Kosovës, ka qenë i mirë gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve lokale të 3 nëntorit 2013, por qe ky bashkëpunim ne te ardhmen mund te përmirësohet dhe te zhvillohet edhe me shume. PZAP-i ka kërkuar në shumë raste raporte të policisë së Kosovës nga vendi i ngjarjes, për të vendosur lidhur më rastet konkrete. Policia e Kosovës i ka ofruar raporte policore PZAP-it në shumicën e rasteve të kërkuar, por ka pas raste që PZAP-i nuk ka pranuar asnjë informatë lidhur më rastin që ka kërkuar informata shtesë, prandaj rekomandojmë që në të ardhmen kërkesat e PZAP-it të kthehen brenda afateve ligjore ngase afatet ligjore janë shumë të limituar sa i përket vendosjes se ankesave që lidhen më ditën e votimit